



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË AMBASADAVE AUSTRIAKE, GREKE, HUNGAREZE, HOLANDEZE, FRANCEZE, TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË MOLDAVISË, TË DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN, TË INSTITUTIT DEMOKRATIK TË KOSOVËS PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 00.05.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

**KËRKUES:** Ambasada Austriake, me adresë Rruga e Xibrakëve nr. 4, Tiranë, dhe me përfaqësues z.Christian Steiner;

Ambasada Greke, me adresë rruga “Skënderbeg”, nr. 8, Tiranë, dhe me përfaqësues zj.Konstantina Kamitsi;

Ambasada Hungareze, me adresë Rruga e Xibrakëve, nr. 47, Tiranë, dhe me përfaqësues z. Adam Lovassy;

Ambasada Holandeze, me adresë rruga “Asim Zeneli”, Tiranë, dhe me përfaqësues z. Reinout Vos;

Ambasada Franceze, me adresë “Rruga Skënderbej 14”, Tiranë, dhe me përfaqësues znj. Elisabeth Barsacq.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Moldavisë, me seli në Chisinau, Moldavi, dhe me përfaqësues zj. Angelica Caraman;

Data: dd mm vvvv

Nr:  
Ora: hh:mm



Për miratimin e e vëzhguesve të Amb.Austriake gazetarve të për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023

Delegacioni i Bashkimit European me seli në Tiranë dhe me përfaqësuese znj. Christiane Hohmann;

Instituti Demokratik i Kosovës, me adresë rruga “Bajram Kelmendi”, Prishtinë, dhe me përfaqësues z. Bajram Kosumi.

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të ambasadave për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

#### V Ë R E J:

Ambasada Austriake i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1(një) vëzhgues afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyes, si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Austriake është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Greke i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 14 (katërbëdhjetë) vëzhgues afatshkurtër dhe 10 (dhjetë) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Greke është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Hungareze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Hungareze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Holandeze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Holandeze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Franceze i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) vëzhgues afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Franceze është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja e Moldavisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. KQZ-ja e Moldavisë është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Delegacioni i Bashkimit European i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Delegacioni i Bashkimit European është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Instituti Demokratik i Kosovës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 9 (nëntë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Instituti Demokratik i Kosovës është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Data: dd mm vvvv

Nr:  
Ora: hh:mm



Për miratimin e vëzhguesve të Amb.Austriake, Greke,Hungareze,Holandeze,Franceze ,KQZ Moldavi,,BE dhe IDK për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

#### **V E N D O S:**

1. Akreditimin e 1 (një) vëzhguesi dhe 2 (dy) përkthyesve të Ambasadës Austriake për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 14 (katërbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 10 (dhjetë) përkthyesve të Ambasadës Greke për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të Ambasadës Hungareze për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 8 (tetë) përkthyesve të Ambasadës Holandeze për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi të Ambasadës Franceze për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të KQZ-së së Moldavisë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve të Delegacionit të Bashkimit Europian për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
8. Akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatshkurtër të Institutit Demokratik të Kosovës për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: dd mm vvvv

Nr:  
Ora: hh:mm



Për miratimin e vëzhguesve të Amb.Austriake,  
Greke,Hungareze,Holandeze,Franceze ,KQZ Moldavi,,BE dhe  
IDK për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes  
vendore të datës 14 maj 2023